



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.06.2023

MBLEDHJA Nr. 30,
Datë 06.06.2023, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 06.06.2023, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 30 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 29.05.2023
2. Mbi miratimin e kërkesës së AAES për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022, “Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
4. Mbi licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sha, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” shpk, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018
7. Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” shpk për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të centralit fotovoltaiik Blue 1 në favor të Green for Growth Fund Southest Europe s.a, SICAV-SIF
8. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI